



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**“MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME PËR  
PROCEDURAT E DHËNIES TË SË DREJTËS SË KALIMIT PËR  
NDËRTIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE  
ME SHPEJTËSI TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të Ligjit Nr. 120/2016 *“Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”*, Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

# **RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT E DHËNIES TË SË DREJTËS SË KALIMIT, PËR NDËRTIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME SHPEJTËSI TË LARTË**

## **Neni 1 Objekti**

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë në pronën publike.

## **Neni 2 Parime të përgjithshme**

E drejta e kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, duhet të ofrohet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, nën kushte të barabarta, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

E drejta e kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, mbi pronën e të tretëve, u jepet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi, duke garantuar përdorimin e pronës, sipas standardeve dhe rregullave të shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

## **Neni 3 Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me atë të ligjit Nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

## **Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet për të drejtën e kalimit**

1. Dhënia e të drejtës së kalimit në pronën publike bëhet nga organi përkatës si:
  - a) nga Bashkia në rastin e shtrirjes së rrjetit në pronën e bashkisë;
  - b) nga institucioni qendror përfaqësues i pronës publike;
2. E drejta e kalimit përfshin, por pa u kufizuar vetëm në, të drejtën për:

- a) të instaluar dhe mbajtur rrjetin e komunikimeve elektronike mbi tokë, nëntokë, mbi ujë apo nën ujë;
  - b) të ndërtuar dhe mbajtur struktura mbështetëse të linjave, pajisje ndërtuese dhe objekte të tjera të linjës si dhe aksesorë shtesë;
  - c) të vendosur linja kabllore në ndërtesa dhe struktura të tjera;
  - d) të vënë në punë sistemet e listuara në pikat a, b dhe c të këtij neni; si dhe
  - e) të heqë pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e ndodhura brenda zonës së sigurisë së rrjeteve të komunikimeve elektronike, të cilat çënojnë sigurinë e funksionimit të tyre duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.
3. Me përfundimin e të drejtës së kalimit, dhe kryerjes së punimeve sipas lejes së ndërtimit të marrë në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit nga Këshilli Kombëtar i Territorit, apo Bashkia, sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike është i detyruar të kthejë pronën e përdorur në gjendjen e mëparshme nëse është parashikuar në kushtet lejes.

## **Neni 5**

### **Rastet e kufizimit**

E drejta e kalimit, nuk ofrohet në rastet kur ajo çënon sigurinë dhe integritetin e rrjetit dhe të pronës, sigurinë kombëtare dhe sigurinë e shëndetit publik. Në çdo rast refuzimi i dhënies së të drejtës së kalimit duhet të dalë me vendim të arsyetuar.

## **Neni 6**

### **Kërkesat për aplikim për të drejtë kalimi**

1. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, në momentin e aplikimit për lejen e të drejtës së kalimit, pranë autoriteteve përgjegjëse, duhet të depozitojë informacionin dhe dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) gjeneralitetet e sipërmarrësit ose emri i regjistruar dhe selia e personit juridik, çertifikata e regjistrimit të aktivitetit, si dhe personat e kontaktit;
  - b) autorizimin e përgjithshëm e lëshuar nga AKEP-i për lejimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
  - c) përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimit të komunikimeve elektronike;
  - ç) të dhëna të plota mbi pronën ku kërkohet të ushtrohet e drejta e kalimit, përfshirë edhe treguesit hartografikë/gjeografikë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;

- d) projektin e shoqëruar me një plan të detajuar të punëve që do të kryhen, ku përfshihen veçanërisht qëllimi, natyra dhe përshkrimi i punimeve të kërkuara, afatet për kryerjen e këtyre punimeve dhe dokumentat grafike ku evidentohen ndërhyrjet e propozuara;
- dh) afatet e parashikuara për realizimin e planit të punëve të parashikuar në shkronjën ‘d’, të këtij neni dhe kohëzgjatjen e punimeve;
- e) vërtetimin e disponimit të mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e veprimtarive të planifikuara;
- ë) garancitë financiare për shpërblimin e dëmit;
- f) çdo dokument tjetër nevojshëm, të përcaktuar paraprakisht dhe të njoftuar nga organi i qeverisjes vendore.
- g) të lëshojë një deklaratë ku të konfirmojë se çdo pajisje e komunikimeve elektronike e instaluar nën tokë, do të jetë në përputhje me kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike sipas legjislacionit në fuqi.
- h) të informohet nga autoritetet përgjegjëse mbi ekzistencën e rrjeteve ekzistuese të komunikimeve elektronike dhe të sipërmarrësve zotërues të këtyre rrjeteve me qëllim shmangien e dëmtimeve në infrastrukturën e rrjeteve të tjera.

## **Neni 7**

### **Lehtësimi i procedurës**

Në rastin e aplikimit për ndërtimin e një rrjeti të ri në pronën publike të bashkisë, aplikimi për të drejtën e kalimit dhe për marrjen e lejes së ndërtimit të rrjetit apo të elementëve të tij do të konsiderohen njëherazi nga bashkia me qëllim lehtësimin e procedurës.

Rregullat për aplikim për leje ndërtimi rregullohen sipas legjislacionit të posaçëm për planikimin e territorit.

## **Neni 8**

### **Afatet për të drejtën e kalimit**

1. Autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës së kalimit shqyrton aplikimin brenda shtatë ditësh nga paraqitja e tij dhe njofton aplikuesin nëse ka nevojë për plotësim të dokumentacionit brenda 10 ditësh nga aplikimi.
2. Autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës së kalimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, merr vendimin për miratimin ose refuzimin e së drejtës së kalimit jo më vonë se 30 ditë nga aplikimi i plotë.

3. Jetëgjatësia e të drejtës së kalimit lëshuar nga autoriteti përgjegjës për dhënien e të drejtës së kalimit mund të jetë deri në 20 vjet.

## **Neni 9**

### **Vendimi për të drejtën e kalimit**

1. Vendimi i Autoritetit Përgjegjës për miratimin e kërkesës duhet të përmbajë:
  - a) shprehimisht miratimin e kërkesës për përfitimin e të drejtës së kalimit dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi;
  - b) të dhënat e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike dhe llojin e veprimtarisë së tij;
  - c) treguesit gjeografikë/hartografikë të sipërfaqes mbi të cilën do të ushtrohet e drejta e kalimit;
  - ç) mënyrën e shpërblimit të dëmit;
  - d) mënyrën e ushtrimit të së drejtës së kalimit;
  - e) sipas rastit detyrimin e sipërmarrësit për të lejuar përdorimin e përbashkët të rrjetit ose deklarin se përdorimi i përbashkët është teknikisht i pamundur;
  - f) kushtet e përdorimit të përbashkët nëse është i mundur.
2. Vendimi i Autoritetit Përgjegjës për refuzimin e kërkesës duhet të përmbajë:
  - a) shprehimisht refuzimin e kërkesës për përfitimin e të drejtës së kalimit dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi;
  - b) të dhënat e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike dhe llojin e veprimtarisë së tij.
3. Sipërmarrësi nuk mund të paraqesë kërkesë të re me të njëjtin objekt dhe shkak nëse Autoriteti Përgjegjës ka vendosur më parë refuzimin e kërkesës, përveçse kur ndryshojnë rrethanat e marra në konsideratë në vendimmarrjen e tij të parë si dhe, kur parashikohet ndryshe në ligj.

## **Neni 10**

### **Ankimi në rast refuzimi**

Kundër vendimit për refuzimin e së drejtës së kalimit, aplikuesi ka të drejtë të ankohet pranë gjykatës administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 11**

### **Detyrimi për informim**

Sipërmarrësi, i rrjeteve të komunikimeve elektronike, pas miratimit të lejes së kalimit dhe pas ndërtimit të rrjetit komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë,

duhet të depozitohet pranë autoritetit përgjegjës dhe AKEP, planimetrinë e rrjetit të ndërtuar.

## **Neni 12**

### **Kërkesat për ndryshime**

Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, ka të drejtë të kërkojë modifikimin, rinovimin ose revokimin e lejes së të drejtës së kalimit, sipas rregullave të miratuara nga autoritetet përgjegjëse.

## **Neni 13**

### **Garantimi i transparencës**

Autoritetet përgjegjëse publikojnë rregullat për procedurat e dhënies së të drejtës së kalimit në faqen zyrtare të internetit dhe/ose në mjediset e ofrimit të shërbimeve.

Rregullat e dhënies së të drejtës së kalimit nga autoriteti përkatës sipas pikës 1, të nenit 4, duhet të jënë lehtësisht të aksesueshme, të qarta dhe të kuptueshme.

Autoritetet përgjegjëse me qëllim lehtësimi të procesit, caktojnë pikën/at e kontaktit për të drejtën e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë e cila duhet të jetë e publikuar.